



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.59

Njësia e Vendosur në Tender Nr.10

Parcelat nr.1-1 dhe 1-29 në ZK Dranashiq

Emri i NSh.-së	NPB Malishgani, Klinë në likuidim ("Ndërmarrja")
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	Më 05 tetor 2022 nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Regjistrimi i Ofertuesit	Nuk ka parakualifikim
Depozita e Ofertës	10,000 Euro
Vendndodhja e Aseteve	Komuna Klinë
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	<p>Kjo shitje përfshin tokën me sipërfaqe 8ha 88ari 39m² (88839m²) në ZK Dranashiq, komuna Klinë e cila përbëhet nga këto parcela kadastrale: P-71006011-00001-1 me sipërfaqe 72786m², kultura mal i klasës 4, P-71006011-00001-29 me sipërfaqe 16053m², kultura bujqesore, arë e klasës 6 dhe mal i klasës 4.</p> <p>Vetem parcela nr. 1-1 ka qasje në rrugë publike. Parcela nr. 1-29 sipas certifikatës së pronësisë ka kulturën arë e klasës 6 dhe mal klasës 4), mirëpo nga ortofoto konstatohet se pjesa dërmuse e parcelës nr. 1-29 është me kulturë pyjore-mal.</p>
Shfrytëzuesit	Nuk ka
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje



Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.



RAPORT I VIZITËS NË TERREN

NPB Malishgan, Parcelat nr.1-1 dhe 1-29 z.k Dranashiq, Klinë

Me datë 07.04.2022 zyrtarët e AKP-së vizituan pronën e NPB Malishgan, konkretisht parcelat me nr.1-1 dhe 1-29 z.k Dranashiq, Komuna e Klinës.

Parcelat sipas certifikatës së pronësisë evidentohen në emër të NPB Malishgan.

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave është prej 88839 m² (8 hektar, 88 ari dhe 39m²) prej të cilave :

Parcela nr. 1-1 ka sipërfaqe prej 72786 m² me kulturë : pyjor , mal i klasës 4;

Parcela nr. 1-29 ka sipërfaqe prej 16053 m² me kulturë : bujqësore, arë e klasës 6.



Ortofoto për parcelat nr.1-1 dhe 1-29 z.k Dranashiq, Komuna e Klinës



Nga vizita jonë në terren konstatuam se :

1. Për shkak të kushteve të vështira të terrenit , vrojtimi i parcelave është bërë nga distanca sepse qasja në parcela ishte e pamundur.
Raportimi është bërë nga analizat e bëra në ortofoto dhe kopje të planit.
2. Nga kopjet e planit konstatojmë se vetëm parcela nr.1-1 ka qasje në rrugën publike me nr.443. Parcela nr.1-29 nuk ka qasje në rrugën publike.
3. Parcela nr.1-29 sipas certifikatës së pronësisë ka kulturë bujqësore (arë e klasës 6) mirëpo nga ortofoto konstatojmë se pjesa dërmuese e parcelës nr.1-29 është me kulturë pyjore-mal.

Fotografia e mëposhtme e realizuar nga largësia prezanton gjendjen e parcelave në z.k Dranashiq.



Pamje e parcelave nr.1-1 dhe 1-29 z.k Dranashiq, Komuna e Klinës.

Dren Gojani-Zyrtar Kadastral Rajonal

Melisa Ceman Morina- Zyrtare e Operacioneve për Administrim të Aseteve

AKP- ZR PEJË/Prill 2022

Informatat

Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me
Publikun dhe Investitorët
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 lok.1090,2059
Fax: +381 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Dritan Hoxha, nr. 55
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës